

## ÇAJUPI – 14 vjeç dhëndër

-Pyetjet me shtjellim-

-shënime-

Çfarë të re solli Çajupi me komedinë “14 vjeç dhëndër”?

Cila është sëmundja për të cilën ankohet Tana?  
Ilustroni mendimin me shembuj.

Cili është kontributi i burrit në këtë familje?  
Gjeni vargje për të ilustruar mendimin.

E ka fajin dembelizmi i Vangjelit që Tana lodhet kaq shumë në këtë familje?

Në planin familjar, e keqja që e ka gjetur Tanën është vetëm lodhja dhe shfrytëzimi i saj i përditshëm?  
Për t’u përgjigjur, mbështetuni në fjalët e Vangjelit:

*Mos më bën të të godit,  
se zakonë s’e harrova.*

Mundohuni të gjeni dhe të analizoni kë vë në lojë me këto fjalë të Vangjelit Çajupi:

*Nga hunda s’më heq dot kurrë,  
Se nuk jam si çdo burrë!  
Jam shqiptar i vërtetë,  
Do bëj si dua vetë!*

-shënime-

Megjithëse Tana i bën të qartë Vangjelit se sëmundja e saj është lodhje nga punët (nga gjendja / statusi i saj), jo sëmundje e vërtetë, përsëri ai këmbëngul të thërrasë jatronë.

**Ç'tregon kjo këmbëngulje e tij?**

Që Tana të lirohet pak nga punët dhe të përmirësojë statusin e saj, mendon martesën e të birit (nusen, si një krah ndihme në shtëpi).

**A është zgjidhje kjo zgjedhje e Tanës?**

Martesa e fëmijëve është një nga dëshirat më fisnike të prindërve.

**Ç'e bën qesharake martesën e kësaj komedie?**

**Si mund ta shpjegojmë këtë moshë dhe këtë diferencë moshe?**

**Ku duket që martesat në moshë të vogël nuk janë diçka që shpik Tana? Pra nuk është faji i Tanës që veprimi i saj (martesa e djalit 14-vjeçar) është komik.**

**Vini re se si e shohin pasurinë e tyre Tana dhe Vangjeli. Nga kjo kuptohet mirë roli i secilit në familje.**

*T: Kemi ara, vreshta shumë...*

*V: Të gjitha ç'duhet i kemi,*

*Si do zoti vetë jemi;*

*Si ne s'ka shumë të tjerë.*

-shënime-

*Minji gdhihet moj Tanë,  
Hajde të flemë pranë,  
Eja se më mori gjumi.*

Janë shtruar probleme të mëdha, që në thelb janë familjare – sociale. Por Vangjelit i flihet.

**Sa i predispozuar është shqiptari të zgjidhë problemet familjare kur ato i dalin përpara?**

Kur Tana këmbëngul për martesën, Vangjeli i nxjerr njëri pas tjetrit shkaqe që martesë nuk është zgjidhja e goditur. Megjithatë në fund martesë vendoset?

**Pse?**

**A tallet autori me Tanën, për vendimin që merr (të martojë djalit) për të shpëtuar nga punët?**

**Komizmi krijohet edhe me vetë fjalët që Tana thotë, të cilat kundërshtojnë në logjikë njëra-tjetrën. Gjejini ato.**

Tana qan në fund, kur e bind burrin për martesën. Ajo thotë se qan nga gëzimi (e kuptueshme për një nënë kur marton fëmijën).

**Gjeni kuptimin e vërtetë të gëzimit të saj.**

*Qa nga gazi,  
Më shpëtove nga marazi.  
Tani do të bënem vjerrë.*

**Cila është figura më tragjike e gjithë pjesës? Shpjegoni pse është e tillë?**

-shënime-

Përveç lidhjes nuse-vjehërr, a mund të vendosim ndonjë lidhje tjetër mes Marigosë dhe Tanës?

Shpjegoni pse situata e mëposhtme është komike? Ndaluni tek nënkuptimi i fjalëve të dy personazheve për të zbuluar komizmin.

*T. (Tek i biri)  
Rri me nusen, djalë,  
dhe foli dy fjalë,  
të mos ketë frikë.  
Dhëndëri (i thotë s'ëmës)  
Ngreu mëm' e ikë.*

Ese paraqitëse

Veçoni elementë të së folmes dialektore dhe shpjegoni si e ka realizuar komiken Çajupi përmes përdorimit të tyre.